

KËRKESË
Nr.4508/3, datë 21.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtimi i linjave kryesore të dërgimit të sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza të Lezhës dhe Shëngjinit për në ITUP-në e qytetit të Lezhës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik””, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit: tokë, arë.

Për pasuritë me pronar të paidentifikuar është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, pasi nuk disponojmë konfirmim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë. Personat të cilët pretendojnë pronësinë mbi këto pasuri duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, në të kundërt nuk do të mund të kompensohen për efekt shpronësimi.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 881 680 (tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi